



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KA.nr. 30/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit BPrAL Kolegji “U...” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit ..., me seli në Prishtinë, kundër të paditurit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi ligjor Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të vendimit nr. 356/2018 të datës 17.08.2018, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 03.10.2022, në mungesë të palëve, me datë 11.10.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit BPrAL Kolegji “U...” Sh.P.K.
- II. ANULOHET vendimi i të paditurit Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektoratit të Punës, nr. prot. 356/2018 i datës 17.08.2018, dhe çështja i kthehet të paditurit në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Paditësi BPrAL Kolegji “U...” Sh.P.K., (...), ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit e Inspektoratit të Punës (IP) nr. 09-58-161/2018 të datës 13.07.2018 dhe vendimit nr. prot. 356/2018 të datës 17.08.2018, si të kundërligjshëm, me arsyetimin se këto vendime janë nxjerrë nën vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe se nuk janë zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe Ligjit të Punës. Paditës ka pretenduar se vendimi i atakuar është në kundërshtim me nenin 84 dhe 85 të Ligjit për Procedurën Administrative pasi akti administrativ përveç tjerash duhet patjetër të përmbajë edhe një përmbledhje të konstatimeve faktike bazuar në provat e paraqitura gjatë procedimit administrativ, një deklaram të bazë ligjore në të cilin bazohet akti dhe arsyetimin e thukët dhe përmbajtjesor të pretendimeve të palës. Gjithashtu ka theksuar se organi administrativ nuk ka vërtetuar saktë gjendjen faktike për shkak se ish e punësuar R.Gj ka lidhur kontratë pune me paditësin me datë 20.01.2017 dhe ka qenë e sistemuar në vendin e punës përgjegjëse e laboratorit të infermierisë dhe kjo kontratë ka qenë e vlefshme deri me datë 20.01.2018, por me datë 15.06.2017 e njëjta ka shkuar në

pushim vjetor, ndërsa nuk është paraqitur në vendin e punës pas përfundimit të pushimit vjetor me datë 04.07.2017. Po ashtu ka deklaruar se i padituri nuk ka marr parasysh pretendimet e paditësit se R.Gj ka themeluar marrëdhënie të re pune dhe për këtë arsye nuk është paraqitur në punë dhe për këtë paditësi ka propozuar që i padituri të kërkoj informacion në ATK. Gjithashtu ka theksuar se nuk janë vërtetuar pretendimet e R.Gj se e njëjta ka shkuar në pushim vjetor nga muaji Qershor 2017 deri në muajin Tetor 2017, pasi që për këtë rrethanë nuk ka pasur asnjë vendim. Në fund ka pretenduar se ish e punësuar nuk ka paraqitur asnjëherë kërkesë për kthim në vendin e saj të punës dhe se të njëjtit do të ishin të gatshëm që ta kthejnë por të kërkonte. Në seancën e shqyrtimit kryesorë të datës 03.10.2022 nuk ka prezantuar edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, andaj gjykata shqyrtimin kryesor të çështjes e ka mbajtur në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se vendimi i nxjerrë nga Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës është i bazuar në të gjitha dispozitat në fuqi dhe pretendimet e palës paditëse për shkelje ligjore nuk qëndrojnë. Gjithashtu ka theksuar se vendimi është marrë bazuar në provat e bashkangjitura në përgjigje në padi ashtu që paditësi nuk ka vërtetuar pretendimet e tij me asnjë provë. Andaj, i padituri i ka propozuar gjykatës që të refuzoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i të paditurit Turpi Ekzekutiv i Inspektorati të Punës nr. 356/18 i datës 17.08.2018. I padituri nuk ka prezantuar në seancën e shqyrtimit kryesorë të datës 03.10.2022 edhe pse ka qenë i ftuar në mënyrë të rregullt, andaj gjykata shqyrtimin kryesor të çështjes e ka mbajtur në mungesë të palëve në procedurë në kuptim të nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Vendim nr. 356/2018 i datës 17.08.2018 i nxjerrë nga Inspektorati i Punës; Vendim nr. 09-58-161/2018 i datës 13.07.2018 i nxjerrë nga Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës; Ankesë ndaj vendimit 09-58-161/2018; Vendim 01nr.09-58-161/2018 i datës 05.04.2018; Raport Zyrtar nr. 01nr.09-58-161/2018, Faturë nr. 000124 e datës 23.07.2018, dëshmi pagese e datës 23.07.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 41 par.3 dhe 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të paditurit si dhe pas shqyrtimit të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata konstatoi se Inspektorati i Punës, me vendimin 01nr. 09-58-161/2018 të datës 05.04.2018 ka aprovuar si të bazuar ankesën 01nr. 09-58-161/2018 të datës 16.03.2018 e parashtruar nga R.Gj për mos njoftimin e mos vazhdimin të kontratës së punës nga ana e këtu paditësit Kolegjit UBT, ashtu që është obliguar punëdhënësi që në afat prej 8 ditëve ta shqyrtoj ankesën e të punësuarës dhe ti bëjë pagesën edhe të një page.

Tutje, Inspektorati i Punës me vendimin 01nr. 09-58-161/2018 të datës 13.07.2018 ndaj subjektit Kolegji UBT ka shqiptuar masën ndëshkimore në shumë prej 800€ (tetë qind euro) për shkak të shkeljes së nenit 71 par.1 të Ligjit të Punës. Kundër këtij vendimi, paditësi me datë 19.07.2018 ka parashtruar ankesë tek organi i shkallës së dytë.

I padituri (kryeinspektori i punës) me Vendimin nr. 356/2018 të datës 17.08.2018 ka refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar dhe ka vërtetuar vendimin e organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës nr. 09-58-161/2018 të datës 13.07.2018.

Paditësi i pakënaqur me këtë vendim, ka ushtruar padi në gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e të njëjtit.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 6 par. 3 të Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë i cili përcakton: *“Kundër vendimit të Inspektoratit të punës mund të ngritet kontesti administrativ në gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh.”*. Po ashtu gjykata shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit kontestues bazuar në nenin 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton: *“Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.”*, nenit 41 par.3 i cili përcakton: *“Nëse në shqyrtim nuk vjen as paditësi dhe as pala e paditur, ndërsa shqyrtimi nuk shtyhet, gjykata do të shqyrtojë konfliktin edhe pa praninë e palëve.”* si dhe bazuar në nenin 44 i cili përcakton: *“1. Ligjshmëria e aktit administrativ të kontestuar shqyrtohet nga gjykata brenda kufijve të kërkesës nga padia, por nuk obligohet nga shkaqet e padisë. 2. Për nulitetin e aktit administrativ gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.”*

Gjykata i vlerësoi të bazuara pretendimet e paditësit sepse vlerëson se vendimi i të paditurit është nxjerrë nën tejkalim të kompetencave ligjore të cilat i ka Inspektorati i Punës sipas Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës dhe Ligjit Nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin e punës nr. 2002/9, këtu ndërlidhur edhe me Ligjin e Punës i cili

përcakton kompetencën për rastet kur i punësuar nuk është i kënaqur me vendimin e punëdhënësit.

Lidhur me kompetencën e të paditurit, gjykata iu referua nenit 2, të Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë i cili përcakton se: “2. *Inspektorati i punës: a) Do të mbikëqyrë zbatimin e ligjit të punës, kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë b) Do t’iu siguroj informacion teknik dhe këshilla punëdhënësëve dhe punëtorëve për çështjet më të efektshme të zbatimit të dispozitave ligjore. c) Do të njoftoj ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale apo ndonjë organ tjetër kompetent për ndonjë mungesë apo ndonjë shpërdorim në ligjin e aplikueshëm. d) Do t’iu siguroj informatat dhe këshillat punëdhënësve dhe punëmarrësve të cilat do të jenë në pajtim me ligjin dhe t’i paralajmërojnë autoritetet kompetente për çfarëdo defektesh apo shpërdorimesh që nuk janë përfshirë me dispozita ligjore ekzistuese. e) Do t’iu jep këshilla për çështje lidhur me ligjin e punës dhe mbrojtjen e punëtorëve me rastin e riorganizimit apo ristrukturimit të një ndërmarrjeje”, si dhe Ligjit Nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin e punës nr. 2002/9, i cili në nenin 3 përcaktuar: “Teksti të pika „a” e nenit 2 „ kushtet e punës dhe mbrojtjen në punë, zëvendësohet më tekstin „Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës, si dhe dispozitave tjera të aplikueshme nga fusha e punësimit dhe mbrojtjes në punë.”*

Po ashtu gjykata ju referua nenit 79 të Ligjit të Punës i cili përcakton se: “Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente.”

Prandaj, mbështetur në dispozitat e lartcekura, për pretendimet nëse të punësuarit i janë shkelur të drejtat e tij me ndonjë vendim apo nëse nuk merr përgjigje brenda afatit të përcaktuar, i punësuar mund që ti drejtohet gjykatës kompetente për shqyrtimin e pretendimeve të tij, ndërsa në anën tjetër kompetencat e Inspektoratit të Punës shtrihen në mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të Punës, Ligjit për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Ambientit të Punës dhe në rast të konstatimit të shkeljeve eventuale, në kuptim të nenit 5 par. 5.5, pika b) dhe c) Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë dhe Ligjit Nr. 03/L-017 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit për inspektoratin e punës nr. 2002/9, Inspektorati i Punës mund të jap vërejtje me shkrim për parregullsitë e konstatuara apo të shqiptoj gjobë, por asesi të obligoj punëdhënësin pagesën e një pagesë shtesë për shkak të mos njoftimit për mos vazhdim të kontratës. Lidhur me këtë, gjykata vlerëson se është kompetencë e gjykatës të vlerësoj nëse ndërprerja e kontratës ka qenë e ligjshme apo nëse të punësuarit është dashur ti dorëzohet njoftimi

për mos vazhdim të kontratës, ndërsa Inspektorati i Punës në përputhje edhe me nenin 83 të Ligjit të Punës ka mundur të shqiptoj vetëm masë ndëshkuese por jo edhe konstatimin e ligjshmërisë së mungesës së njoftimit për mos vazhdim të kontratës dhe obligimin për pagesën të edhe një page.

Neni 4 i Ligjit nr.05/L-031 përcakton kufizimin e organeve publike që veprimtarinë tyre ta realizojnë brenda kompetencave të tyre. Në par. 1 të këtij neni është përcaktuar se: *“1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.”*. Po ashtu në par.2 është përcaktuar se: *“2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj.”*

Bazuar në këtë, gjykata vlerëson se autoriteti i organeve administrative, në këtë rast i të paditurit Inspektorati i Punës, duhet të shtrihet deri në atë masë sa nuk tejkalon kufijtë e kompetencës të cilat me ligj të veçantë janë përcaktuar tek një institucion tjetër, në këtë rast, të gjykatës.

Gjykata vlerëson se i padituri ka tejkaluar kompetencat e tij kur në vendimin kontestuese, ka konstatuar se paditësi, vendimin e vet për mos vazhdimin e kontratës së punës së ankueses, e ka nxjerrë në kundërshtim me neni 71 par. 1 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës dhe ka obliguar paditësin që në afat prej 8 ditëve ta shqyrtoi ankesën e ankueses R.Gj dhe ti bëjë pagesën edhe për një pagë.

Neni 52 i LPPA përcakton se: *“1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.1. është nxjerrë në mungesë të autorizimit nga një ligj, sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; 1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë...”*. Po ashtu, neni 43 par. 2 i LKA-së përcakton se: *“2. Nëse gjykata konstaton se konflikti administrativ nuk mund të shqyrtohet në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurën administrative për shkak se në pikëpamje të fakteve të vërtetuara ekzistojnë kontradikta në akte, gjë që në pikat esenciale nuk janë vërtetuar plotësisht, e që nga faktet e vërtetuara është nxjerrë konkluzioni jo i drejtë në pikëpamje të gjendjes faktike, ose konstaton se në procedurën administrative nuk janë respektuar rregullat e procedurës, që do të kishin rëndësi për zgjidhjen e çështjes, gjykata do të anulojë me aktgjykim aktin e kontestuar administrativ. Në një rast të tillë, organi kompetent ka për detyrë të veprojë ashtu si është caktuar në aktgjykim dhe të nxjerrë akt të ri administrativ.”*

Në këtë drejtim, gjykata e obligon organin e paditur, në kuptim të nenit 65 të Ligjit për Konfliktet Administrative, që në afat prej tridhjetë (30) ditësh, në ri procedurë të veproj sipas vërejtjeve të dhëna në këtë aktgjykim, dhe pasi t'i mënjanoj të metat e cekura lidhur me kompetencën e saj, të merr vendim të drejtë, e të bazuar në ligj, me të cilin do të njoftohen palët me kohë.

Gjykata shqyrtimin e nulitetit të vendimit kontestuese e bëri sipas detyrës zyrtare në kuptim të par. 2 të nenit 44 të LKA-së.

Prandaj, gjykata vlerëson i padituri nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur ka vendosur që të refuzojë ankesën e paditësit kundër Vendimit të organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës 01nr. 09-58-161/2018 të datës 13.07.2018 pasi që nuk janë zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 43 par.2, 44 dhe 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.30/22, datë 11.10.2022

Gjyqtari

Arnis Dumani

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimin të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.